



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



COMNET-A  
Ardian KURTESHI  
Drejtor  
Pozharan



**VENDIM**

**Lidhur me Ankesën nr. 2019/107 Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër  
COMNET-A("Palë Përgjegjëse")**

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datë 11 dhjetor 2019, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01, ka realizuar një monitorim në terren në selinë e tij në Pozharan dhe Partesh.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 12 dhjetor 2019, ka gjetur se Pala Përgjegjëse është duke ritransmetuar kanalet e platformës së operatorit Kujtesa Net pa ndonjë marrëveshje valide të deponuar në KPM edhe përkundër faktit se në katalogun e kanaleve të deklaruar në momentin e licencimit figurojnë vetëm vetëm tri kanale si: "INFO CHANNEL, TV PULS, TV MOST DHE TV MIR", duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, ë Rregullores KPM 2016/01.
4. KPM nuk ka pranuar asnjë dëshmi me shkrim nga Pala Përgjegjëse se ka bërë ndryshimin e katalogut të programeve apo ka arritur marrëveshje për ritransmetim të kanaleve të ndonjë operatori të shpërndarjes në këtë rast të Kujtesa Net, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
5. KPM, pas të gjeturave nga monitorimi me datën 17 dhjetor 2019, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM 2016/01, duke udhëzuar që mënjëhere pas pranimit të Njoftimit t'i largojë nga transmetimi të gjitha kanalet e platformës së

operatorit Kujtesa Net për të cilat kanale nuk posedon marrëveshje për transmetimin e tyre. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

6. KPM, nuk ka pranuar përgjigje nga ana e Palës Përgjegjëse lidhur me Njoftimin e dërguar për ritransmetimin e kanaleve të platformes Kujtesa Net pa të të drejtën e ritransmetimit të tyre.

### Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse, është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

*“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.”*

8. KPM, bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01, duke ritransmetuar pa marrëveshje valide kanalet e platformes Kujtesa Net, përcaktuar me nenin 4, paragrafi 1 i Rregullores KPM 2016/01, i licencuari është i obliguar që për çdo shpërndarje të ofruesve të shërbimit medial ta bëjë vetëm duke u bazuar në marrëveshje valide.
9. Komisioni i KPM-së konstaton se Pala Përgjegjëse ka dështuar të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

### Vendimi

10. Urdhëron Palën Përgjegjëse që të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e kanaleve të platformes së operatorit Kujtesa Net dhe çdo përmbajtje tjetër programore për të cilat nuk posedon marrëveshje për të drejtën e transmetimit, në mënyrë që të veprojë në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
11. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 2,000 (dymijë) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
12. Nëse Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij Vendimi nuk i heq kanalet e operatorit Kujtesa Net nga platforma e shpërndarjes ose ndonjë përmbajtje tjetër programore për të cilat nuk posedon marrëveshje për të drejtën e transmetimit, Komisioni i KPM-së do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

### E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
15. Një ankesë e pranueshme paraqitet brenda afatit të caktuar dhe vendimi i nxjerrë nga Bordi për Ankesa e mbështet vendimin e KPM-së. Megjithatë në raste të veçanta, nëse vendoset nga KPM-ja, sanksioni i vënë duhet të hyjë në fuqi menjëherë. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

### Ekzekutimi i Vendimit

16. Ankesa e parashtruar kundër këtij vendimi nuk e pengon ekzekutimin e tij dhe se ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga Pala Përgjegjëse, ashtu siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 2, pika 2 të Ligjit të KPM-së.

  
Muja FERATI  
Kryetar



02.03.2020  
Datë